



**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
INSTITUTI I GJEOSHKENCAVE**

**RREGULLORE E BRENDSHME PER FUNKSIONIMIN E  
INSTITUTIT TE GJEOSHKENCAVE GJATE FAZES KALIMTARE**

*(BAZUAR NE VKM NR. 561, DATE 22.08.2007)*

**TIRANE 2008**

**RREGULLORE E BRËNDËSHME**  
**INSTITUTI I GJEOSHKENCAVE (IGJEO)**  
**(PËR FUNKSIONIMIN E TIJ NË PERIUdhËN KALIMTARE)**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

Instituti i Gjeoshkencave (IGJEO), me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 561, datë 22.08.2007 është institut për kërkim e zhvillim, në përbërje të Institucionit të Arsimit të Lartë (IAL) Universitetit Politeknik Tiranë (UPT), si njësi kryesore e tij.

**Neni 2**

Në IGJEO, sipas VKM nr.561 të datës 22.08.2007, bashkohen ish-Instituti Sizmologjisë që bënte pjese në Akademinë e Shkencave, si dhe disa nga njësitë kërkimore të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, përkatësisht Drejtoria e Administrimit të Territorit dhe Pasurive Minerale, Drejtoria e Gjeoinformatizimit dhe Drejtoria e Gjeofizikës së Aplikuar dhe Topogjeodezisë, të cilat shkëputen nga ky shërbim dhe organizohen në IGJEO si njësi kryesore pranë UPT.

**KREU II**  
**MISIONI DHE DETYRAT KRYESORE**

**Neni 3**

**Misioni i Institutit**

Misioni i Institutit të Gjeoshkencave është:

- a) Kërkimi shkencor, bazë dhe i aplikuar;
- b) Formimi universitar i thelluar i studentëve dhe shkencëtarëve të rinj;
- c) Shërbimet për të tretë, në fushën e sizmologjisë dhe transferimin e njohurive e të teknologjisë, në fushat e sizmologjisë, pasurive natyrore, gjeoriskut, gjeoinxhinierisë dhe gjeoinformacionit.

**Neni 4**

**Detyrat kryesore**

Detyrat kryesore të IGJEO-s janë:

- a) Studimi i fenomeneve gjeologo-gjeofizike, etj, dhe ndërtimi i hartave gjeotematike;
- b) Studimi dhe vlerësimi i pasurive minerale, i materialeve të ndërtimit, burimeve nëntokësore, energjisë dhe resurseve ujore nëntokësore;
- c) Studimi gjeopedologjik i territorit;
- d) Studimi i rreziqeve natyrore dhe të atyre të shkaktuara nga veprimtaria e njeriut;
- e) Studimi dhe monitorimi i vazhdueshëm i aktivitetit sizmik dhe i lëkundjeve të forta tërmetore, si dhe njoftimi në kohë reale i organizmave shtetërore dhe i publikut;
- f) Studime të mikrozonimit për vlerësimin e rrezikut sizmik, në nivel rajonal e vendor;

- g) Adaptimi i standardeve europiane dhe përpunimi i metodikave bashkëkohore të analizës dhe projektimit antisizmik;
- h) Studime gjeofizike, rajonale e vendore, në kuadër të hartografimeve gjeologjike, të studimeve të gjeomjedisit, arkeologjisë, energjisë gjeotermale, etj.
- i) Zhvillimi i modeleve gjeoinformatike dhe i teknologjive të gjeoinformacionit ;
- j) Formimi universitar, kryesisht në ciklin e dytë e të tretë të studimeve dhe kualifikimi shkencor i shkencëtarëve të rinj.

### **KREU III**

#### **ORGANET DHE AUTORITETET DREJTUESE**

#### **Neni 5**

##### **Organet dhe autoritetet drejtuese**

Organet dhe autoritetet drejtuese të IGJEO janë:

- Këshilli Drejtues (KD);
- Drejtoria;
- Drejtori;
- Përgjegjësit e departamenteve.

#### **Neni 6**

##### **Detyrat të Këshillit Drejtues**

Këshilli Drejtues (KD) drejton veprimtarinë e IGJEO-s gjatë periudhës kalimtare deri në zgjedhjen e organeve dhe autoriteteve drejtuese. Detyrat kryesore të KD janë:

- Harton kuadrin rregullator të veprimtarisë së e IGJEO-s (rregulloret, etj.);
- Harton planin afatgjatë të zhvillimit të e IGJEO-s dhe ia paraqet për miratim senatit;
- Përcakton fushat parësore të kërkimit dhe formimit universitar dhe, në varësi të tyre, i propozon senatit grupet kërkimore-mësimore që do të ngrihen në IGJEO
- Përcakton kriteret e punësimit për personelin akademik ;
- Drejton procedurat e konkurrimit të hapur për emërimin e titullarëve të grupeve;
- Harton raportin vjetor (përfshirë atë financiar) si dhe atë përfundimtar , në mbyllje të periudhës kalimtare dhe ia dërgon senatit për miratim;
- I propozon rektorit të UPT-së, në përfundim të periudhës kalimtare, shpalljen e zgjedhjeve të organeve dhe autoriteteve drejtuese të IGJEO-s;
- Përgatit dhe drejton procesin e zgjedhjes së organeve dhe autoriteteve të institutit.

#### **Neni 7**

##### **Përbërja e Këshillit Drejtues**

Këshilli Drejtues përbëhet nga 9 anëtarë:

- a) Drejtori i cili është dhe Kryetar i KD;
  - b) Katër anëtarë të brëndshëm (Përgjegjës të departamenteve);
  - c) Katër anëtarë të jashtëm, të emëruar nga Ministri i Arësimit dhe i Shkencës.
- Nëndrejtori dhe Kancelari marrin pjesë në mbledhjet e KD pa të drejtë vote.

## **Neni 8 Drejtoria**

Drejtoria e IGJEO-s është autoriteti kryesor, e cila drejton, nën mbikqyrjen e KD veprimtarinë e përditshme të institutit. Drejtoria përbëhet nga Drejtori, Nëndrejtori dhe Kancelari.

Funksionet kryesore të Drejtorisë janë:

- harton programin vjetor të veprimtarive, dhe ndjek zbatimin e tij pas miratimit në KD;
- zbaton kriteret për shpërndarjen e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore;
- përcakton përparësitë të kërkesave konkurruese për financime midis departamenteve;
- harton dhe propozon projektbuxhetin për miratim në KD;
- propozon planin për investime, kontratat dhe marrëveshjet, që janë kompetencë e tij;
- paraqet rekomandime për projektet e kërkimit dhe ndryshimet e nevojshme strukturore;
- zbaton vendimet e miratuara nga Këshilli Drejtuesi Institutit, Senati Akademik, Këshilli i Administrimit dhe Rektori i UPT;
- monitoron dhe publikon rezultatet e vlerësimit të veprimtarive të institucionit;
- propozon marrëveshje ndërmjet institucioneve të UPT-së për rregullat e financimit;
- propozon strukturën e përgjithshme dhe numrin e personelit të institucionit;
- përgatit rregulloren e brendshme të Institutit dhe e paraqet atë për miratim në KD.

Drejtoria raporton së paku një herë në 3 muaj në KD.

## **Neni 9 Drejtori**

Drejtori është autoriteti drejtues i IGJEO-s dhe e përfaqëson atë.

Veprimtaria e përgjithshme e IGJEO-s organizohet dhe udhëhiqet nga Drejtori. Ai ndihmohet në veprimtarinë e tij nga Nëndrejtori dhe nga Përgjegjësit e Departamenteve.

Drejtori kryen këto veprimtari kryesore:

- organizon dhe drejton veprimtarinë e përgjithshme të IGJEO-s, e përfaqëson atë zyrtarisht në UPT, institucionet e tjera publike dhe private të vendit e të huaja, si dhe me organizata e fondacionet shkencore ndërkombëtare;
- thërret dhe drejton mbledhjet e Këshillit Drejtues dhe Drejtorise të IGJEO-s; mbikqyr veprimtarinë e departamenteve, si dhe ndjek e analizon realizimin e detyrave të planeve të punës kërkimore-shkencore;
- raporton përpara organeve drejtuese të UPT dhe para KD, për realizimin e veprimtarisë së IGJEO-s dhe për realizimin e buxhetit;
- vendos për shpenzimet e buxhetit, për probleme që lidhen me administrimin dhe përdorimin e mjeteve financiare të mjediseve të punës, teknikës dhe logjistikës;
- në periudhën kalimtare nënshkruan kontratat me afat të kufizuar me punonjësit e Institutit;
- emëron e shkarkon Nëndrejtorin dhe Përgjegjësit e departamenteve;
- emëron e shkarkon personelin ndihmës shkencor dhe administrativ si dhe për lëvizjet nga një detyrë në një tjetër;
- vendos për shpërblimin dhe masat ndëshkimore;
- vendos për specializim dhe kualifikime të personelit akademik, pasi të të ketë marrë mendimin e Përgjegjësve të Departamenteve.

**Neni 10**  
**Nëndrejtori**

Nëndrejtori ndihmon Drejtorin në kryeyrjen e detyrës së tij.  
Nëndrejtori, në mungesë të përkohëshme të Drejtorit, ushtron të gjitha kompetencat dhe mban përgjegjësitë për drejtimin e IGJEO-s.

**Neni 11**  
**Kancelari**

Kancelari është përgjegjës për drejtimin administrativ dhe financiar të përditshëm të institutit, për zbatimin e buxhetit, për mbikëqyrjen dhe kontrollin e veprimeve financiare, si dhe për zbatimin e ligjshmërisë.

Kancelari duhet të kete formim jurist ose ekonomist me së paku 5 vjet përvojë pune.  
Kancelari emërohet nga Rektori në bazë të propozimit të Këshillit Drejtues.

**Neni 12**  
**Përgjegjësi i Departamentit**

Përgjegjësi i departamentet përgjigjet për organizimin dhe mbarevajtjen e punës në departament. Ai përgjigjet për zbatimin e detyrave të caktuara nga Drejtori. Harton planin e zhvillimit të departamentit dhe e paraqet atë për miratim në Drejtori.

**KREU IV**  
**PERSONELI**

**Neni 13**  
**Personeli i Institutit**

Personeli i IGJEO-s përbëhet nga personeli akademik, personeli ndihmës-shkencor dhe personeli administrativ. Detyrat dhe të drejtat e personelit përcaktohen në Statutin e UPT dhe në Rregulloren e tij.

**Neni 14**  
**Personeli akademik**

Personeli akademik kryen kërkim shkencor, mësimdhënie, shërbime për të tretë dhe detyra administrative. Personeli akademik përbëhet nga kategoritë “Profesorë”, “Docentë” dhe “Lektorë”.

Në kategorinë “Profesorë” përfshihet personeli me titujt akademikë: “Profesor i asociuar”, “Profesor”, “Profesor emeritus” dhe “Akademik”.

Në kategorinë “Docentë” përfshihet personeli me titullin akademik “Docent” ose me gradën shkencore “Doktor”.

Në kategorinë “Lektorë” përfshihet personeli me diplomë “Master i Nivelit të Dytë”.

Kriteret e punësimit të personeli akademik, gjatë periudhës kalimtare, përcaktohen nga Këshilli Drejtues.

### **Neni 15** **Personeli akademik i ftuar**

Me propozim të departamenteve, Këshilli Drejtues fton personel akademik për periudha kohore të përkohshme deri një vjecare. Përzgjedhja e personelit të ftuar, behet duke harmonizuar nevojën e njësisë për kërkim me kualifikimet e tyre.

### **Neni 16** **Personeli akademik me kontratë**

IGJEO ka të drejtë të kërkojë të punësojë me kontratë personalitete, vendase dhe të huaj. Ai ka të drejtë të kërkojë të punësojë me kontratë të përkohëshme edhe studentë që kryejnë studimet e doktoratës.

### **Neni 17** **Punësimi**

Kriteret për punësim për çdo kategori personeli përcaktohen nga Këshilli Drejtues, i cili përcakton procedura për përzgjedhjen e kandidatit që i përgjigjet më mirë përshkrimin të vendit të punës. Kandidatët fitues lidhin me Institutin kontratë pune të përsëritshme me afat të pacaktuar.

Personelit i ndërpritet marrëdhënia e punës, në përputhje me Kodin e Punës, kur nuk përmbush detyrimet e caktuara në kontratë, shkel rregullat etike të jetës akademike, të statuteve dhe rregulloreve.

### **Neni 18** **Viti akademik sabatik**

Personeli akademik ka të drejtë që çdo 7 vjet, për periudha kohe deri në një vit, të punojë për përparimin e tij akademik, sipas kriterëve të përcaktuara në Statutin dhe rregulloret e UPT.

## **KREU V** **KËRKIMI SHKENCOR, SHËRBIMET DHE TRANSFERIMI I NJOHURIVE DHE** **TEKNOLOGJISE**

### **Neni 19** **Veprimtaria kërkimore**

- a) IGJEO kryen kërkim shkencor bazë e të aplikuar, studime dhe projekte për zhvillim, veprimtari të tjera krijuese dhe transferim te njohurive dhe te teknologjive. Personeli akademik kryen kërkim për zhvillim për të tretë, pa cenuar plotësimin e detyrimeve të njësisë përbërëse.
- b) Planifikimi i kërkimit bëhet mbi plane, programe dhe projekteve të miratuara. Performanca e kërkimit të te gjitha llojeve e niveleve vlerësohet nga Këshilli

Shkencor.

- c) Tematikat dhe afatet e kërkimit, drejtimet dhe vëllimi i punëve përcaktohen nga vetë IGJEO, mbështetur në nevojat e zhvillimit të vendit, projektet për kërkim e zhvillim, programet e bashkëpunimit, aftësimin e personelit dhe burimet financiare në dispozicion.
- d) IGJEO kryen edhe shërbime të kualifikuara, si ekspertiza, analiza, këshillime, monitorime, etj.
- e) IGJEO ka të drejtë të hartojnë programe dhe projekte kërkimore me institucione të tjera, publike ose private, brenda dhe jashtë vendit, si dhe me shoqata, fondacione etj. IGJEO paraqet raport vjetor për veprimtarinë kërkimore të zhvilluar.
- f) Tarifat e studimeve si dhe të shërbimeve për të tretë propozohen nga departamenti dhe miratohen nga Këshilli Drejtues.
- g) Të ardhurat e krijuara nga Instituti shkojnë tërësisht në favor të tij. Një pjesë e tyre mund të përdoren edhe për pagese të personelit pjesëmarrës në veprimtari. Masa e shpërblimit të personelit pjesëmarrës në këtë veprimtari, përcaktohet në përputhje me kontributin e secilit pjesëmarrës dhe miratohet nga Këshilli Drejtues.

## **Neni 20 Këshilli i Profesorëve**

Këshilli i Profësorëve i IGJEO-s është organ kolegjal i përbërë nga personel akademik me titull “Profesor”. Numuri minimal i Këshillit të Profësorëve është shtatë veta. Në të bëjnë pjesë i gjithë personeli akademik in Institutit me titull “Profesor” dhe i punësuar me kohe të plotë.

## **Neni 21 Këshilli Shkencor**

Këshilli shkencor i IGJEO-s është organ kolegjal i përbërë nga personel akademik me tituj e grada shkencore që shqyrton propozimet për projekte dhe programe të reja kërkimi shkencor si dhe raportet e rezultateve të kërkimit shkencor dhe i paraqet Këshillit Drejtues vlerësimin e tij.

Në përbërje të Këshillit Shkencor mund të marrin pjesë edhe antarë të jashtëm, deri në 30% të Këshillit Shkencor. Antarët e jashtëm duhet të jene autoritete shkencore në fushat përkatëse. Ata caktohen nga Drejtori i Institutit mbas konsultimit me Pergjegjësit e departamenteve.

Këshilli shkencor kryesohet nga Drejtori, i cili ndihmohet nga Sekretari i Këshillit Shkencor, që caktohet nga Kryetari dhe duhet të ketë titull ose gradë shkencore.

## **KREU VI** **NJESITE PERBERESE**

### **Neni 22**

Departamentet jane njësi bazë që përfshijnë fusha kërkimi homogjene dhe që bashkërendojne e administrojne kërkim e mësimdhënie.

IGJEO kalon një periudhë kalimtare nga një deri në dy vjet gjatë të cilës organizohet në njësi përbërëse departamente dhe grupe kerkimore-mësimore si më poshtë vijon:

- a) Departamenti i Gjeoresurseve dhe Gjeoinxhinierisë;
- b) Departamenti i Gjeofizikës dhe Gjeoriskut;
- c) Departamenti i Sizmologjisë dhe Inxhinierisë Sizmike;
- d) Departamenti i Teknologjive të Gjeoinformacionit.

Laboratorët, stacionet monitoruese, biblioteka, arkiva etj. jane njësi ndihmëse.

## **KREU VII** **SHERBIMI I MONITORIMIT SIZMOLOGJIK**

### **Neni 23**

Instituti i Gjeoshkencave ka per detyre shtetërore:

1. Te drejtoje punen ne Rrjetin Sizmologjik te Shqiperise, te monitoroje aktivitetin sizmik te vendit si edhe te mbledhe, ruaje, perpunoje, analizoje dhe te botoje te dhenat sizmologjike, qe fitohen nepermjet ketij rrjeti. Te njoftoje me urgjence institucionet e larta shteterore si edhe organet e specializuara shteterore te mbrojtjes civile dhe ATSH, ne rast se brenda territorit te Shqiperise bien termete me Magnitudë më të madhe se katër ( $M > 4$ ).
2. Te shkembeje te dhenat e Rrjetit Sizmologjik me ato te institucioneve te ngjashme ne rajon, Europe dhe ne Bote si edhe me Qendrat Nderkombetare Sizmologjike sipas detyrimeve te miratuara. Per termete te medhenj ne rajon dhe Europe te njoftoje Qendrat Nderkombetare te Sizmologjise sipas procedurave dhe mjeteve te miratuara.

## **KREU VIII** **SIGURIMI I CILËSISË – AKREDITIMI**

### **Neni 24**

IGJEO është përgjegjëse për sigurimin e brëndshëm të cilësisë dhe ngre njësinë perkatese. Njësia vlerëson efikasitetin e kërkimit dhe atyre administrative e financiare të institucionit.

Njësia ka autonomi dhe akses në të gjitha të dhënat e institucionit. IGJEO publikon rezultatet e vlerësimit që kryhen.

### **Neni 25**

Vlerësimi i jashtëm i cilësisë kryhet nga Agjencia e Akreditimit të Arsimit të Lartë, në

nivel institucional dhe programesh studimi e mbështeten në standardet shtetërore të cilësisë. Akreditimi është periodik dhe realizohet për çdo 5 vjet.

## **KREU IX** **ADMINISTRIMI FINANCIAR DHE BURIMET E FINANCIMIT**

### **Neni 26**

IGJEO është institucion buxhetor. Mjetet financiare sigurohen nga buxheti i shtetit si dhe nga burime të tjera, shërbimet, projekte, dhurata, subvencione e sponsorizime. Veprimtaria financiare realizohet përmes UPT, në përputhje me standardet e autonomisë financiare të percaktuara në Ligjin e Arsimit të Lartë, Vendimet e Këshillit të Ministrave dhe Statutin e UPT.

### **Neni 27**

Auditimi i brendshëm në njësitë përbërëse të UPT realizohet nga auditimi i MASH dhe i UPT. Rezultatet e kontrollit dhe auditit bëhen publike.

### **Neni 28**

Mbeshtetur në VKM nr.561, datë 22.08.2007, IGJEO-s i kalojnë të gjitha asetet, burimet financiare, mjediset, labororet, zyrat, automjetet, donacionet, projektet, infrastruktura, rrjeti telefonik, arkivat e çdo dokumentacion të ish Institutit të Sizmologjisë dhe atyre të njësive kërkimore të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar të percaktuara me VKM të sipërcituar.

## **KREU X** **ADMINISTRATA**

### **Neni 29**

Kancelari, i ndihmuar nga zyra e Financave, harton planin vjetor dhe perspektiv financiar për fondin e pagave, sigurimet shoqërore, shpenzime për personelin, etj. Ndjek zbatimin e marrëdhënieve me Degen Ekonimike të UPT. Ndjek financimin e punimeve të investimeve etj. Mban dokumentacion kontabël, organizon inventarizimin e përgatit bilancet. Harton listat mujore operative për sigurimin e materialeve për blerje. Ndjek veprimtarinë e realizimit të të ardhurave dhe mirë administrimin e tyre.

Arshiviste administrate, protokolliste, sekretare, është punonjësi që evidenton, sistemon e ruan arkivin administrativ të institutit sipas rregulloreve arkivore dhe çdo vit bën inventarizimin e tyre. Protokollon shkresat e hyrjes dhe daljes nga instituti si dhe ato brenda institutit. Mban protokollin e mbledhjeve të drejtorisë. Mban në kasafortë vulën e institutit dhe e përdor atë vetëm me urdhër të drejtorit. Vula mund të përdoret vetëm nga personi i autorizuar me shkrim nga drejtori.

### **Neni 30**

Propozimet për ndryshime në rregulloren e brëndëshme të institutit bëhen nga drejtori. Ato shqyrtohen dhe miratohen nga Këshilli Drejtues.

**DISPOZITA KALIMTARE DHE TE FUNDIT**

**Neni 31**

Instituti i Gjeoshkencave kalon një periudhë kalimtare nga një deri në dy vjet, gjatë së cilës vepron si njësi kryesore në kuadrin e UPT-së, e organizuar në departamente dhe grupe kërkimore-mësimore, në zbatim të VKM nr. 561, datë 22.08.2007.

Në përfundim të periudhës kalimtare, Këshilli Drejtues i propozon Rektorit të UPT-se shpalljen e zgjedhjeve për organet dhe autoritetet drejtuese të IGJEO-s, në përputhje me ligjin nr. 7941, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Miraturar në Mbledhjen e Këshillit Drejtues, datë 9.10.2008.

**KRYETARI**

**Prof. Ismail HOXHA**